

DUKES SH.P.K.

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

DUKES sh.p.k.

Sot, më datë **31.01.2024** (Dymijë e njëzetë e katër) në Vlorë krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "DUKES" sh.p.k. nga ortaku i vetëm :

Z. **Gazmend Cekodhima**, shtetas shqiptar, lindur më 10.06.1967 në Vlorë dhe banues në Vlorë dhe me nr. Personal **G706102890**

1. dhe letërnjoftim nr. 034328224 lëshuar në datë 05.06.2019, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

KAPITULLI I

EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

Neni 1

Emri

- 1.1. Shoqëria do të quhet DUKES sh.p.k. (Këtu e më poshtë "Shoqëria")
- 1.2. Shoqëria është person juridik , do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjësi të kufizuar dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" . Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.

Neni 2

Selia e Shoqërisë

2.1. Selia e shoqërisë **DUKES** sh.p.k. do të jetë në Vlorë, Rruga Nacionale Vlore-Himare, Fshati Radhime, Kompleksi DUKE ' S, Objekt me KonstarkSION te Lehte Nr.1. me Nr. Pasurie: 405/3 dhe Zona Kadastrale Nr. 3140. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar. Kohëzgjatja e Shoqërisë mund të ndryshohet një ose më shumë herë me vendim të ortakut të vetëm.

Numer kontakti: 00355685467893

e-mail: g.cekodhima@gmail.com

Gazmend Cekodhima

Neni 4

Objekti

4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë do të jetë si vijon :

Bar,restorant,hoteleri,shitje me shumice dhe pakice te artikujve industrial. Stacion plazhi. Sherbime ne fushen e akomidimit turistik. Investitor ne fushen e ndertimit. Çdo veprimtari tjetër në funksion me sa është përcaktuar më lartë .

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR

NENI 5

Kapitali Themeltar

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 (Një) kuotë me vlere nominale 100.000 (Njëqindmijë) lekë.

Z. Gazmend Cekodhima zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë, pra një kuotë në vlerë nominale 100.000 (Njëqindmijë) lekë.

Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të asamblesë së ortakëve themelues. Kuotat e Pjesëmarrësve në kapital janë te gjitha të emëruara dhe të pa ndashme.Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Cdo kuote i takon e drejta e një vote.

NENI 6

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit te shoqërisë DUKES shpk e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- Shitblerjes;
- Trashegimisë;
- Dhurimit;
- Çdo mënyrë tjetër e parashikuar në ligj

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Ortaku ose ortakët e tjerë kanë të drejtën e blerjes së parë . Këto të drejta ortakët duhet ti ushtrojnë brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të asamblesë për shitjen e kuotave.

Në rastin e mos ushtrimit të së drejtës së blerjes së parë, ortaku që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emrin e blerësit dhe kushtet, të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato të ofruara të ortakët e tjerë të shoqërisë.

Gazmend Cekodhima

NENI 7

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
 - b. Ndryshimet e statutit
 - c. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
 - d. Emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat c dhe d të këtij neni
 - f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
 - j. Përfaqesimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l. Miratimin e rregullave procedurale për mbledhjen e asamblesë;
 - m. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat g dhe h të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund ti kundrejtoje pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvec rastit kur shoqëria provon së i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bërë, mjetet e xhiros, pasuri të luajtshme ose te paluajtshme etj të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë. Kuotat e kapitalit janë të pasqyruara dhe të regjistruara në librat e llogarisë të shoqërisë.

NENI 8

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky statut, nga dispozitat e ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe nga përcaktime të ligjeve të tjera në fuqi dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

Gjergjend Cepedini

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (Tre) muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 dhe 5 kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotrohet nga një ortak i vetëm/asambleja e ortakëve.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

NENI 9


Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim, ose nëse parashikohet nga statuti, njoftimi mund të bëhet më anë të postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 10

Kërkesa nga ortakët e pakicës

1. Ortakët, të cilët përfaqesojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund të drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e e çështjeve të posacme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjen për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.
2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej tyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:



- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
 - b) ti kerkojë shoqërisë, blerjen e kuotave të zotëruara prej tyre.
3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtij ligji.
 4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë cdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar. Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve në proporcion me përqindjen e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar në ligj .

NENI 11


Përfaqësimi në asamble

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 12

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shumë se 40% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ceshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas Nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ose me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të Nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.



KAPITULLI I III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 13

Kompetencat e ortakut

13.1 Ka të drejtë të administrojë aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund të kryejë, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kanë të drejtë të marrin dijeni për rezultatet ekonomiko-financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj. Kanë të drejtë të marrin pjesë vetë ose me anë të përfaqësueseve në këtë aktivitet.

13.2 Kanë të drejtë të tërheqin të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë për tre vjetët e fundit

13.3 Kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe mund të shesin pjesën e kapitalit të tyre në përputhje me kushtet që i lejon statuti dhe ligji.

13.4 Ortakët në përputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin në fuqi kanë, të drejtë që në të njejtën kohë të jenë ortakë edhe në shoqëri të tjera.

13.5 Ortakët rezervojnë të gjitha te drejtat sipas ligjit Tregtar.

NENI 14

Ortaku i vetëm **Z. Gazmend Cekodhima** vendos që shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj **z. Gazmend Cekodhima** me Nr. Pershonal **G706102890** për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

NENI 15

Administrimi i shoqërisë

15.1 Administratori ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, me qëllim që të arrijë objektivat e saj, përveç atyre që ligji ia atribuon ortakëve.

15.2 Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.

15.3 Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për dëme të kryera gjatë administrimit. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi ndaj administratorit.

15.4 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut/ve, ka të drejtë të veprojë, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

Gazmend Cekodhima

15.5 Shoqëria administratohet nga të paktën 1(një) dhe maksimumi 3(tre) administratorë , të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqje për një periudhë 5 (pesë) vjecare.

15.6 Çdo administrator do të ketë të drejtë për rimbussimin e shpenzimeve të bëra prej tij për llogari të shoqërisë.

15.7 Kur administratori i shoqërisë rezulton i suksesshëm në punën e tij dhe në rezultatin financiar të kompanisë atëherë ortakët vendosin lidhur me shpërblimin që do ti jepet atij në fund të vitit financiar .

NENI 16

Detyrat e Administratorit/ëve

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe të drejta.

- Të mirë administroje pasurinë e shoqërisë
- Të lidhë marrëveshje me të tretët Brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të caktuara nga ortakët.
- Të zbatojë rregullat e brendeshme të shoqërisë
- Të shpërblejë dëmet që i vijnë shoqërisë si pasojë e veprimeve apo mos veprimeve të tij.
- Të paguhet për punën e kryer në bazë të marrëveshjes së bërë midis tij dhe ortakëve.
- Të marrë të dhëna e të bëjë propozime mbi gjithcka që ai e quan të dobishme për shoqërinë
- Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre dhe ti paraqesë ato sipas rastit për miratimin përfundimtar nga ortakët
- Të bëhen propozimet përkatëse ortakut të vetëm kur lind nevoja për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Të miratojë aktet normative që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin e personelin
- Të përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë dhe të krijojnë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Ti propozojë ortakëve për krijimin e njësive e strukturave të ndryshme si filiale, degë e përfaqësi në qytetet të tjera të vendit ose jashtë shtetit.
- Të përgatisë propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ia paraqesë ortakut/ve për miratim. Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtarë të komisionit të likuidimit si dhe të paraqesë propozimet për miratim para ortakëve .
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të Vendimeve të Ortakëve.
- Të kryejë çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

Signature

NENI 17
EKSPERTI KONTABEL

17.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo viti financiar. Caktimin e tyre e bën administratori

17.2 Eksperti kontabël mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit të shoqërisë

17.3 Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

17.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi .

17.5 Nuk mund te ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratorët, personat që janë në gjini e krushqi deri në shkallën e katërt. Po ashtu nuk mund te kryejnë këtë detyrë përgjegjësat e zyrave, filialeve e agjensive.

KREU III
MARRËDHENIET E PUNËS

NENI 18

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çështjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 19

Për çdo mos marrëveshje që mund të lindë midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

NENI 20

Sekreti i punës

Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.

KAPITULLI I IV

VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT


NENI 21

Viti financiar

Vitit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Përrjashtimisht Viti i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Shoqëria "DUKES" sh.p.k. do të caktojë një Ekspert Kontabël kur të jetë e nevojshme.



NENI 22

Inventari dhe llogarite vjetore.

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore

Në mbylljen e vitit financiar administratori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për vitin financiar .

NENI 23

Raportet vjetore

23.1 Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortakët.

23.2 Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

23.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortakët sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 24.

Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.


24.1 Nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar pasi zbriten humbet e vitit të mëparshëm, hiqet mënjane një shumë e barabartë me jo më pak se 5 % (pesë për qind) e fitimit e destinuar për formimin e fondit rezervë të quajtur "rezervë e domosdoshme".

24.2 Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme kur kjo rezervë arrin 10 % të kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 10 % të kapitalit.

24.3 Ortakët mund të vendosin edhe zbritje të veçantë në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

NENI 25

Të ardhurat eventualisht të ndjekura nga shoqëria çdo vit financiar janë të destinuara siç është vendosur nga ortakët duke i qëndruar në uljen 5 % që do ti destinohet rezervës ligjore.



KAPITULLI V
MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 26

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentabel gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

NENI 27

27.1 Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakët caktojnë një likuidator, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e sipër".

27.2 Likuidatori i emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe e vendos menjëherë në dispozicion të ortakëve.

27.3 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 28


Ortakët vendosin mbi rregullshmërinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuidatorit.

Ortakët mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuidatori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakëve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

NENI 29

Kur ortakët për shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes, likuidimit dhe dokumentacioni i nevojshëm depozitohen në regjistrin tregtar në Q.K.B. dhe Shoqëria ç'regjistrohet prej tij.



DISPOZITET KALIMTARE

NENI 30

Dispozitat e fundit

30.1 Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

30.2 Për efekt të inteprentimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nënkuptohet Ligji nr 9901 datë 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare”

30.3 Pavlefshmëria eventuale e dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojë vlefshmërinë e tij.

NENI 31

Gjykata kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve dhe intepretim e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

NENI 32

Hyrja në fuqi

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortaku/ët.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“ DUKES ” sh.p.k.

